



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1430 Prot.

Tiranë, më datë 28.12.2022

VENDIM  
Nr. 552, datë 28.12.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 28.12.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Konceptit të sondazheve arkeologjike, në kuadër të projektit “Stabilizimi emergjent i një pjese të murit verior të Kalasë së Lezhës” Me aplikues Lorenc Bejko dhe zhvillues zyrat e UNOPS Shqipëri;
  2. Gjatë procesit të kryerjes së sondazheve, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren nga specialistët e DSHA dhe DRTK Tiranë sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
  3. Rezultati i sondazheve të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM-së;
  4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
  5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
  6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Eugen KALLFANI

